



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 377/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Albgarden” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-52025-02-27-2018, me objekt: “Blerje pemësh për rritje të kapaciteteve të gjelbërta”, me fond limit 4 166 666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 13.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

Ankimues:

“Albgarden” sh.p.k
S/Strada Lezhë-Shkodër, Km 1, Lezhë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Sarandë
Rruga “Abedin Dino”, Lagjia nr 1, Sarandë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.03.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-52025-02-27-2018, me objekt: “*Blerje pemësh për rritje të kapaciteteve të gjelbërta*”, me fond limit 4 166 666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 13.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

II.2. Në datën 27.03.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|------------------------|------------------------------|
| 1. “Albgarden” sh.p.k | 3.333.365 lekë, skualifikuar |
| 2. “Green Farm” sh.p.k | 3.905.000 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “Albgarden” sh.p.k rezulton i skualifikuar me argumentat e mëposhtme:

“*OE nuk përmbush kriteret e dst-ve pika 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: germa c) “Te paraqitet vertetim qe verteton se operatori ekonomik nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt Bashkise Sarande percaktuar sipas Ligjit nr 9632,date 30.10.2006 “Per taksat vendore ne Republiken e Shqiperise” te ndryshuar si dhe detyrime te tjera te mundshme qe rrjedhin*

nga kontrata te caktuara, leshuar jo me pare se 5(pese) dite perpara dates se zhvillimit te tenderit”. Vertetimi leshohet kundrejt kerkeses se bere nga operatori ekonomik ne Bashkine Sarande, Drejtoria Ekonomike. Ky OE nuk ka paraqitur kete vertetim dhe nga verifikimet e kryera rezulton se eshte debitor kundrejt institucionit te Bashkise Sarande.”

II.3. Në datën 03.04.2018 operatori ekonomik “Albgarden” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...] Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar shoqërinë tonë në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendimin nr.914, datë 20.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për të plotësuar këtë kriter të përgjithshëm të kualifikimit, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, shoqëria jonë ka paraqitur kërkesën nr. 505/1, datë 06.03.2018, drejtuar Bashkisë Sarandë, për pajisjen e shoqërisë sonë me vërtetimin që kjo shoqëri nuk ka detyrime kundrejt kësaj bashkie, kërkesë të cilën e kemi dërguar dhe me postë dhe kemi marrë konfirmimin nga posta që është pranuar nga Bashkia, konfirmuar se e ka marrë këtë kërkesë më datë 08.03.2018, bashkëlidhur dëftesë pranimi i objekteve postare nr. 4501, datë 06.03.2018, ku shënohet: Dërguesi “Albgarden” sh.p.k dhe marrësi Bashkia Sarandë dhe konfirmimi i marrjes së kërkesës. Kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi dhe mandat pagesën e faturës për arkëtimin e vlerës së taksave vendore ndaj kësaj Bashkie, në të cilin vërtetohet se shoqëria jonë ka shlyer të gjitha taksat vendore në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Kreu II “Taksat Vendore”, neni 9 “Llojet e taksave vendore”. Gjithashtu meqënëse Bashkia Sarandë qëllimisht nuk ka lëshuar vërtetimin si më lart, shoqëria jonë në këtë procedurë prokurimi ka plotësuar deklaratën mbi detyrimet e taksave dhe tatimeve vendore për Bashkinë Sarandë, kjo në respektim të Vendimit nr. 914, datë 20.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes”, ku parashikohet se: “Përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së, realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rats se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.”

Në këtë procedurë prokurimi shoqëria jonë ka dorëzuar vërtetimet ku vërteton se nuk ka detyrime ndaj njësisve administrative të qeverisjes vendore për të gjitha vëndet ku ushtron aktivitetin e saj sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

Në respektim të ligjit nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”, shkronja “e” ku parashikohet se: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetatrëve nëpërmjet: e)realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative”, Bashkia Sarandë duhet të na kishte pajisur me vërtetimin përkatës mbi detyrimet e taksave vendore (të paguara ose jo), pasi është një shërbim i kërkuar nga shoqëria jonë me shkresë.

Pretendimi i Bashkisë Sarandë se shoqëria “Albgarden” sh.p.k është debitore ndaj saj, duke u bazuar në rekomandimet e lëna nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit në këtë Bashki, ku është

rekomanduar që Bashkia Sarandë t'i kërkojë shoqërisë sonë pagimin e dëmit në masën 557.760 lekë si kamat vonesa për shkeljet e afateve kontraktore, nuk qëndron për arsye se këtë rekomandim të KLSH-së, zbatuar nga Bashkia Sarandë, shoqëria jonë e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, pas hetimit gjyqësor, me vendimin nr. 740, datë 19.12.2017 ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesë padisë.
2. Anulimin pjesërisht të Urdhërit nr. 84, datë 25.05.2017 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për masën për dëmshpërblim në lidhje me detyrimin e caktuar ndaj shoqërisë, palë paditëse "Albgarden" sh.p.k, bazuar në Raportin e KLSH-së sipas programit të kontrollit nr. 1236/14 prot., datë 28.04.2017.

Ky vendim nuk ka marrë formë të prerë, pasi është ankimuar nga pala paditëse Bashkia Sarandë. Në këto kushte, pra kur akti administrativ që ngarkon shoqërinë tonë me një detyrim po shqyrtohet në rrugë gjyqësore, nuk mund të penalizohet shoqëria për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit me autoritetin kontraktor Bashkia Sarandë. Raste analoge janë për paraqitjen e vërtetimit që vërteton se operatori ka detyrime për energjinë elektrike ku parashikohet se mospërbushja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përvec rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Bashkia Sarandë ka detyrimin ligjor në respektim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për taksat vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pajiste shoqërinë tonë me vërtetimin mbi mospasjen e detyrimeve ndaj saj, por nuk e ka lëshuar këtë vërtetim për të penalizuar shoqërinë tonë në këtë procedurë prokurimi. Shoqëria jonë pagesën e detyrimeve (taksa dhe tatime vendore) ndaj Bashkisë Sarandë e vërteton me mandatin e pagesës, paraqitur në këtë procedurë prokurimi [...]. Gjithashtu në zbatim të Vendimit nr. 495, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", Kreu IV, "Përfitimi i të dhënave apo dokumentave administrative elektronike nga Institucionet Publike", pika 13, në të cilën parashikohet se "Institucionet Publike, të cilat shqyrtojnë kërkesa të ndryshme për përfitimin e një shërbimi, por që për shkak të procedurës administrative nevojiten dokumenta të tjera të lëshuara nga institucione publike, i përfitojnë ato direkt nga ndërveprimi i bazës të të dhënave shtetërore, qarkullimit të dokumentit elektronik dhe dokumentit administrativ elektronik apo nëpërmjet aksesit në portalin elektronik për llogari të personave fizikë dhe juridikë". Autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë kishte mundësi të verifikimit të këtij vërtetimi, pasi është vetë ky institucion që e lëshon."

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.882/1 prot., datë 11.04.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke refuzuar ankesën si vijon:

"[...] Ju si operator ekonomik jeni skualifikuar me arsyetimin se: "Subjekti nuk përmbush kriteret e dokumentave të tenderit pika 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: germa c)Te paraqitet vertetim qe verteton se operatori ekonomik nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt Bashkise Sarande, percaktuar sipas Ligjit nr 9632,date 30.10.2006 "Per taksat vendore ne Republikën e Shqiperise", te ndryshuar, si dhe detyrimeve te tjera te mundshme qe rrjedhin nga kontrata te caktuara, leshuar jo me pare se 5(pese) dite perpara dates se zhvillimit te tenderit. Vertetimi leshohet kundrejt kerkeses se bere nga operatori ekonomik ne Bashkine Sarande,

Drejtoria Ekonomike”. Shoqëria “Alb Garden” sh.p.k nuk e plotëson këtë kusht sepse ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por rezulton të jetë debitor ndaj Bashkisë Sarandë, në vlerën 557.760 lekë, bazuar në Urdhërin nr.84 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH për masat për shpërblim dëmi”. Ky fakt ju është bërë i ditur me shkresën nr.2496 prot., datë 30.06.2017. Gjithashtu ju e keni kundërshtuar në rrugë gjyqësore urdhërin nr.84 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për masat për shpërblim dëmi”, duke kërkuar anulimin e tij. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka konkluduar me vendimin nr. 740, datë 19.12.2017. Këtë vendim Bashkia Sarandë e ka apeluar dhe çështja është ende në gjykim. Përsa kohë nuk jemi përpara një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Urdhri nr.84 i Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për masat për shpërblim dëmi” është ende në fuqi, ju vazhdoni të jeni debitor kundrejt Bashkisë Sarandë.

Ju vërtet i jeni drejtuar Bashkisë Sarandë me shkresën nr. 505/1 prot., datë 06.03.2018, më kërkesë për pajisjen me vërtetim se operatori ekonomik “Alb Garden” sh.p.k nuk ka asnjë lloj detyrimi kundrejt Bashkisë Sarandë, duke ushtruar një të drejtë ligjore, por e keni kryer këtë kërkesë me dijëni të plotë se ju jeni debitor bazuar në Urdhërin nr.84 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për masat për shpërblim dëmi” dhe sigurisht që ky fakt do të pasqyrohej edhe në përgjigjen që do t’ju jepej.

Fakti që nuk keni marrë vërtetimin fizikisht dhe rrjedhimisht nuk e keni pjesë të dokumentacionit të tenderit, nuk është shkaku i skualifikimit. Sic shprehen edhe anëtarët e KVO-së: “OE nuk ka paraqitur këtë vërtetim dhe nga verifikimet e kryera rezulton se ky OE është debitor kundrejt Bashkisë Sarandë.” Pra Komisioni nuk është mjaftuar me mungesën e paraqitjes fizike të vërtetimit, por ka bërë verifikimet përkatëse mbi qënien ose jo debitor kundrejt Bashkisë Sarandë, të shoqërisë “Alb Garden” sh.p.k pranë Drejtorisë së Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike të Bashkisë Sarandë. Vetëm pasi ka marrë informacion mbi debitorinë prej 557.760 lekë që ka shoqëria “Alb Garden” sh.p.k, bazuar në Urdhërin nr. 84 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për masat për shpërblim dëmi”, është marrë vendimi për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, përgjatë procesit të vlerësimit, ka vepruar në përputhje të plotë me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sepse ju si operator ekonomik nuk përmbushni kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe si rrjedhim nuk mund të kualifikoheni në procedurën e tenderit me objekt: “Blerje pemësh për rritje të kapaciteteve të gjelbërta” me fond limit 4.166.666 lekë pa TVSH.”

II.5. Në datën 19.04.2018 operatori ekonomik “Albgarden” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, parashtuar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 02.05.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 786/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1086/1 prot., datë 27.04.2018 me objekt: “Dërgim informacioni

mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit “Blerje pemësh për rritje të kapaciteteve të gjelbërta””, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Albgarden” sh.p.k pasi: *“rezulton të jetë debitore ndaj Bashkisë Sarandë, në vlerën 557.760 lekë, bazuar në Urdhërin nr.84 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH për masat për shpërblim dëmi”*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, *“Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”* gërma “c” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:

“Te paraqitet vertetim qe verteton se operatori ekonomik nuk ka asnje lloj detyrimi kundrejt Bashkise Sarande, percaktuar sipas Ligjit nr 9632,date 30.10.2006 “Per taksat vendore ne Republiken e Shqiperise”, te ndryshuar si dhe detyrime te tjera te mundshme qe rrjeshin nga kontrata te caktuara, leshuar jo me pare se 5(pese) dite perpara dates se zhvillimit te tenderit. Vertetimi leshohet kundrejt kerkeses se bere nga operatori ekonomik ne Bashkine Sarande, Drejtoria Ekonomike.”

III.1.2. Në nenin 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar parashikohet se *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

a) *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

c) *gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale,*

paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.”

III.1.3. Në nenin 45 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “Autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues, kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për ndonjë nga veprat e mëposhtme:

a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash.

d) fallsifikim

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentet e përmendura në pikën 3 të këtij neni dhe, kur ka dyshime, mund t’u drejtohet organeve kompetente për të marrë ndonjë informacion të nevojshëm për integritetin dhe gjendjen personale të ofertuesve në fjalë. Kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, atëherë autoriteti kontraktor mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente.

2. Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

ç)

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë seksion, ose nuk ka pranuar t’i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente:

a) vërtetim nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të njëvlershëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikat 1 e 2, shkronjat “a”, “b” e “c”;

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

III.1.4. Sipas autoritetit kontraktor ankimesi është skualifikuar pasi: “[...] ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por rezulton të jetë debitore ndaj Bashkisë Sarandë , në vlerën 557.760 lekë, bazuar në Urdhërin nr.84 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH për masat për shpërblim dëmi”.

III.1.5. Duke vlerësuar shkaku skualifikues të operatorit ekonomik ankimes në rastin konkret KPP gjykon se nuk ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 45 të LPP, pasi vetë legjevenesi ka përcaktuar rastet e vecanta kur autoriteti kontraktor ka të drejtë të përjashtojë nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit publik një operator të caktuar ekonomik. Pra *lex specialis* parashikon në mënyrë eksplicite rastet në të cilat autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues i cili ndodhet në një nga kushtet e parashikuara shprehimisht në nenin 45 të LPP sa pësipër cituar.

Sa më sipër, për sa kohë që *lex specialis* ka parashikuar në mënyrë shteruese rastet e përjashtimit të operatorëve ekonomikë dhe se rasti i mësipërm nuk parashikohet në nenin 45 të LPP, KPP gjykon se skualifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Albgarden” shpk nga autoriteti kontraktor nuk është i drejtë.

III.1.6. Akoma më tej referuar parashtrimeve me shkrim të autoritetit kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka ngritur pretendime se operatori ekonomik është debitor dhe detyrimi ekziston në atë masë që është përcaktuar nga raporti i KLSH deri në një vendim të formës së prerë nga gjykata, ndërsa në nenin 77 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se : “[...] 2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë. [...]”

III.1.7. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit në tërësi Komisioni vëren se për pretendimet e mësipërme mbi ekzistencën e detyrimeve të pretenduara nga ana e autoritetit kontraktor, ky i fundit në respekt të parashikimeve ligjore të *lex specialis* dhe VKM 914/2014 në asnjë rast nuk ka ngritur pretendime, apo të marrë masa për përjashtimin e operatorit ekonomik dhe/ose të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik për shkeljen e detyrimeve kontraktuale nga ky i fundit.

Sa më sipër Komisioni gjykon se në rast se autoriteti kontraktor do të kishte pretendime në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorit ekonomik ankimues (sikundër në rastin konkret për punë të pakryer dhe përfitim të padrejtë), ka patur në dispozicion disa momente procedurale për rregullimin e marrëdhënies juridike, sikundër është zgjidhja e mosmarrëveshjes referuar parashikimeve ligjore të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës dhe Kodit Civil si edhe detyrimin për paraqitjen e informacionit të sipërcituar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për nisjen e procedimit hetimor për rastin konkret.

Gjithashtu, konstatohet se ankimuesi ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore urdhërin nr.84 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, datë 25.05.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për masat për shpërblim dëmi”, duke kërkuar anulimin e tij dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, pas hetimit gjyqësor, me vendimin nr. 740, datë 19.12.2017 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe anulimin pjesërisht të Urdhërit nr. 84, datë 25.05.2017 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë për masën për dëmshpërblim në lidhje me detyrimin e caktuar ndaj shoqërisë “Albgarden” sh.p.k, bazuar në Raportin e KLSH-së sipas programit të kontrollit nr. 1236/14 prot., datë 28.04.2017. Këtë vendim Bashkia Sarandë e ka apeluar dhe çështja është ende në gjykim.

Autoriteti kontraktor, bazuar në raportin e KLSH-së, duhet të ndërmerre hapa konkretë ligjor për vjeljen e detyrimeve kundrejt subjektit mbi të cilin pretendohet se ka punë të pakryer dhe përfitime të padrejta, referuar kontratës së lidhur mes palëve.

Në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk ka dokumentuar se ka ndërmarrë ndonjë nga hapat e mësipërme, duke nisur nga përfundimi i kontratës për të cilën ngrihen pretendime deri në momentin e vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit objekt ankimi, KPP gjykon se në rastin konkret nuk mund të shërbejë si kusht për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik eksperiencia e tij e mëparshme me autoritetin kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albgarden” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-52025-02-27-2018, me objekt: “Blerje pemësh për rritje të kapaciteteve të gjelbërta”, me fond limit 4 166 666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 13.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Albgarden” sh.p.k, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.

3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albgarden” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 786 Protokolli,

Datë 19.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

